



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.05.2019, ora 11.00

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”. (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Ardit Konomi, Robert Bitri, Dritan Bici, Arlind Çaçani, Nimet Musaj, Zef Shtjefni Rrahman Rraja, Kujtim Gjuzi dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Gjetan Gjetani dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Indrit Osmani – përfaqësues i ARSA Animal Rescue Albania

Jonel Kristo – përfaqësues i ARSA Animal Rescue Albania

Artan Syziu – përgjegjës Sektori ne Sektorin e Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë

Esmeralda Velaj – specialiste e Drejtorisë së Vlerësimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Kleves Janku – përfaqësuese e Ministrisë së Bujqësisë

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit.

Në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”, nismë e një numri të konsiderueshëm zgjedhësish, 37 mijë, por mund të jenë edhe më tepër. Mund të jetë ndoshta pak i vonuar, por ndryshimi i Kodit Penal është një proces që nuk zhvillohet dot shpesh, ndaj janë mbledhur disa çështje së bashku për të bërë shqyrtimin e ndryshimeve në këtë kod.

Ne dje kemi pasur një takim, filluam diskutimin e propozimeve për ndryshimet në Kodin Penal për disa çështje që lidhen me dhunën në sport, dhunën ndaj personave të zgjedhur, bluzave të bardha, sigurinë ushqimore, sigurinë mjedisore, dhe sot, si pjesë e kësaj tërësie ndryshimesh, vjen një nismë shumë qytetare, dhe unë, në fakt, edhe në emrin tuaj, dua ta vlerësoj dhe ta përshëndes si një shenjë emancipimi të shoqërisë sonë dhe të rritjes së ndjeshmërisë ndaj mjedisit, në rastin konkret ndaj kafshëve. Është një hap shumë i rëndësishëm të përafrimit të sistemit tonë të vlerave edhe me atë Perëndimor, të cilit duam t’i bashkohemi.

Falënderoj përfaqësuesit dhe të gjithë zgjedhësit që na kanë sjellë një ndjeshmëri mbase jo shumë të zakonshme që duket si jo e zakonshme në zallamahinë tonë politike të ditës, me tema shumë të nxehta, por ja që temat e nxehta kanë punën e tyre, ndërkohë, ndjeshmëritë qytetare, çështjet mjedisore, çështjet e mirëqenies së kafshëve, me të cilat nuk jemi mësuar të merremi sa duhet këtu në Shqipëri, nuk duhet të humbin gjithashtu momentumin e tyre.

Pa humbur kohë, ftoj zotin Baraj, që është relatori i kësaj nisme të bëjë një prezantim të përgjithshëm, dhe më pas përfaqësuesit e Animal Rescue Albania zotin Indrit Osmani dhe zotin Jonel Kristo, të cilët i falënderoj për prezencën, që do të bëjnë një prezantim më të zgjeruar dhe më pas do të kalojmë në pyetje, sqarime, komente edhe nga anëtarët e komisionit.

Besnik Baraj – Faleminderit!

Edhe unë bashkohen me të gjitha komentet që bëri kryetari i komisionit. Vërtetë është e pazakonshme që në komision të na vijnë nisma ligjore të kësaj natyre dhe unë e çmoj shumë, veçanërisht sepse ka të bëjë me një aspekt që realisht mungon në Shqipëri dhe rëndom e shikojmë se si keqtrajtohen kafshët.

Me këtë rast do të doja të sillja në vëmendje një shprehje të një nobelisti gjerman, diku në vitet '52-'53, ku shprehet se: "Kur njeriu të fillojë të respektojë qenien më të thjeshtë, qoftë ajo bimë ose kafshë, atëherë nuk do të ketë më nevojë që të edukohet për të respektuar qenien e ngjashme me vetveten". Në Shqipëri e gjejmë rëndom mosrespektimin e njëri-tjetrit dhe unë e quaj këtë nismë si një premisë për të na edukuar të gjithëve ne si qytetarë dhe ca më shumë kur vjen puna si politikbërës, që të mos japim ato shfaqe në parlament që i shohim në seanca të ndryshme, kur kemi qenë pozitë-opozitë.

Në tërësi propozimi lidhur me trajtimin e kafshëve, ai që i vret ato, i dëmton për arsye të ndonjë ligësie, nuk i mban në rrethana dhe kushte të përshtatshme, unë jam dakord për të gjitha, përjashtuar një rasti kur bëhet fjalë për kushtet higjieno-sanitare, meqenëse ne mund të kemi edhe njerëz që janë në kushte higjieno-sanitare jo të përshtatshme, jo të standardeve që do të donim, dhe sigurisht, në qoftë se ata mbajnë kafshë, nuk do t'i mbajnë dot më mirë se kushtet në të cilat jetojnë vetë. Kështu që lidhur me këtë, shpreh rezervat e mia.

Nga ana tjetër, do të thosha, se meqenëse për herë të parë futet një ligj i tillë dhe ju me siguri keni adoptuar standardet e ligjeve të ngjashme në Bashkimin Europian, ndoshta për një pjesë të madhe të qytetarëve, apo të vogël të tyre, do të duken pak të ekzagjeruara dhe ne duhet ta rishikojmë që ky ligj të jetë i zbatueshëm në drejtim të penalteteve që ndërmerren, qoftë financiare, qoftë deri në burgim, sepse, në qoftë se ne bëjmë një ligj që ka një hendek shumë të madh me psikologjinë e vendit, ka rrezik që të mos zbatohet.

Në këto rrethana do të thosha se është shumë pozitive futja e këtij ligji, por para se të ngjitemi në katin e shtatë, që janë vendet e tjera, që realisht kur i projektojnë dhe i adoptojnë ligjet, i zbatojnë, me qëllim që në Shqipëri ta kemi të zbatueshëm këtë ligj, ndoshta duhen rishikuar penaltetet, të jenë pak më të zbutura për psikologjinë dhe sjelljen e njerëzve. Mendoj se do të jetë një kufizim i madh në drejtim të sjelljes jo të mirë ndaj kafshëve në përgjithësi.

Jam i mendimit (gjithashtu kemi punuar edhe me ekipin mbështetës të komisionit dhe i falënderoj në këtë rast se kanë bërë një relacion të plotë), që këtë ligj, pasi ta sjellim në formatin e duhur, t'ia bashkojmë projektligjit që diskutuam dje, në mënyrë që të krijojmë një kre të veçantë për trajtimin e kafshëve dhe të fitojmë në kohë për ta miratuar bashkë me të gjitha ndryshimet që do të bëjmë në Kodin Penal.

Ju falënderoj për nismën, të cilën e quaj një premisë shumë pozitive me ndikim edhe në sjelljen e njerëzve në tërësi në Shqipëri, veçanërisht edhe në parlamentin tonë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Baraj!

Fjalën e kanë përfaqësuesit e zgjedhësve nga organizata Animal Rescue Albania.

Zoti Bitri ka një pyetje paraprakisht, dhe më pas fjalën e keni ju.

Robert Bitri – A u keni marrë firmat e qytetarëve për këtë nismë?

Niko Peleshi – Patjetër! Janë depozituar 37 mijë firma, ndërkohë unë kam një indicie, që numri mund të jetë shumë më i madh se kaq. Gjithsesi, të përgjigjet zoti Kristo.

Jonel Kristo – Zoti Peleshi, faleminderit!

Zoti Baraj, faleminderit!

Falënderoj të gjithë komisionin, për kohën që po i kushtoni kësaj nisme!

Dua të ndalem te dy fjalët që përdorët ju, zoti Peleshi, “e paprecedentë” apo “e pazakontë”. Vërtet është e pazakontë që janë 37 mijë e 500 firma zyrtarisht të depozituara në vitin 2017. Unë me Indritin tallem shpesh, që nëse do të hidhnim kandidaturën për deputetë, a do t’i mblidhnim dot ne 37 mijë e 500 firma nesër? Për këtë kauzë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk janë firma të qenve, janë qytetarë me karta të depozituara. Në fund të vitit 2017 janë depozituar 37 mijë e 500 firma.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Niko Peleshi – Ju lutem, të dëgjojmë zotin Kristo!

Jonel Kristo - E dyta, është e vërtetë që është nismë e vonuar. Firmat janë depozituar në vitin 2017, por, pavarësisht kësaj, shumë mirë që jemi këtu. Zoti Peleshi, zyrtarisht kanë qenë rreth 40 mijë firma. Ne, për të kapur afatin e depozitimit, ndaluan te 37 mijë e 500 dhe Indriti e di që kemi ende firmëtarë sa herë ne lançojmë nismën për ndryshimin e projektligjit dhe Kodit Penal. Po të kishim vazhduar, jam i sigurt që do të kishim më tepër, që tregon shumë për sensitivitetin e kësaj nisme.

Në vitin 2017 ndodhën shumë ngjarje, që na e derdhën kupën. Më kryesorja ka qenë ajo që mori edhe shumë vëmendje mediatike, vrasja e një qeni në Dhërmi nga një fëmijë i vogël 14-vjeçar. Ne vendosëm të thoshim atë që ne dinim për treguesit e hershëm të kriminelë të dhunshëm, që në historikun e tyre, në biografinë e tyre më të hershme, kishte shenja të dhunës ndaj kafshëve. Pothuajse mbi 90% të kriminelëve të dhunshëm në të gjithë botën kishin gjurmë të dhunimit të kafshëve në fëmijëri. Ne menduam ta përdornim këtë si argument.

Kanë qenë disa fotografi të tjera, për shembull nëse e keni parasysh shqiponjën, simbol kombëtar yni, që varej në bagazhin e një “benx”-i, ujku i egër ose linksi, që e kemi pasuri kombëtare. Të gjitha këto ne menduam t’i konkretizonim në një nismë dhe në vitin 2017 propozuam publikisht të mblidhnim firma për të bërë ndryshime në Kodin Penal.

Lajmi i fundit, në janar të vitit 2019, është nisma e deputetëve të Kosovës, që kanë bërë ndryshime në Kodin Penal. Ne u kemi vënë përpara një kopje të botuar në Fletoren Zyrtare të Kosovës për ndryshimet që kanë bërë në Kodin Penal dhe janë më tepër se 10 nene. Projektligji që kemi marrë nga nisma është në faqen e pasme të dokumentit që u kemi vënë përpara.

Ne e dimë problemin që kemi me kafshët, e dimë stigmën që ata kanë dhe mendoj që ka ardhur koha të shkojmë drejt një emancipimi tjetër. Në projektligjin e parashikuar kemi përfshirë disa nene me gjoba dhe burgim. Mund të ndryshohet, siç tha edhe zoti Baraj, të përshtatet me kontekstin, që të mos bëhet irealist dënimi përkatës, pavarësisht se në Kosovë shkon deri në 3 vjet burgimi, jo vetëm për vrasje, por dhe për gjëra më të thjeshta. Gjermania e ka ndalimin e keqtrajtimit të kafshëve në Kushtetutë. Vende të tjera, si Letonia, janë bashkuar me standardin më vonë dhe kanë ligje të posaçme. Ne duam që në kuadrin rregullator që kemi aktualisht për faunën e egër të shtonim edhe këtë për kafshët shtëpiake. Projektligji që kemi propozuar nuk merret thjesht me faktin që unë vrava një qen dhe çfarë më gjen mua, por krijon standardin për pikat e shitjeve të kafshëve, çfarë duhet të plotësojnë që të më shesin mua një kafshë. Propozojmë se nëse unë jam pronar i një pike të shitjes së kafshëve, kur Indriti vjen për të blerë një qen, duhet t’i bëjë veting nëse është i aftë për ta mbajtur apo jo, njësoj sikur të birësojë një person, sepse, nëse ai qen del jashtë i egërsuar dhe vret një person tjetër, e ka Indriti fajin, apo e kam edhe unë, që e shita në mënyrë të papërgatitur? Në projektligjin e propozuar ne mundohemi t’i adresojmë këto dhe kushtet higjienosanitare. Indriti është jurist dhe ndoshta shkon më për shtat me ju, ndaj do ta lë të flasë për detajet që ne kemi propozuar, por jemi të hapur për çdo pyetje.

Indrit Osmani – Faleminderit!

Joneli pothuajse i tha të gjitha dhe unë nuk kam shumë për të shtuar, por dua të jap kurajën time. Unë e kuptoj që ndoshta mund të jetë shumë e vështirë për deputetët sot në Republikën e Shqipërisë të flasin për kafshët dhe për më tepër të miratojmë ligje dhe ndryshime në Kodin Penal, por mendoj se shoqëria jonë e ka arritur këtë nivel. Pra, ne nuk jemi më ajo shoqëri që nuk guxojmë të flasin për kafshët, sepse si çdo qenie tjetër, si edhe ne, kanë të drejtën

e jetës, të mos keqtrajtohen, të mos vriten, të drejtat e tyre, sigurisht jo si të drejtat tona, por një nivel dhe një standard si në të gjitha vendet e Bashkimit European dhe botës, që tashmë e kanë sanksionuar.

Joneli përmendi disa nene të Kodit Penal të Kosovës. Ne nuk e dinim dhe u impresionuam shumë që Kosova e kishte miratuar brenda këtij viti. Projektligji nuk ka ardhur në bazë të një nisme qytetare, por vetë politikanët e Kosovës e kanë miratuar.

Zoti Baraj, jam shumë dakord me ju, mund të rishikoni pjesën e dënimeve ose dispozitat në tërësi, mund t'i ndryshoni, mund të shtoni të tjera për veprat penale që kanë të bëjë me mjedisin, të cilat këtu nuk janë përfshirë, dhe Kodi Penal ka nevojë, pasi është shumë i prapambetur, por për sa i përket pjesës së higjienës, kur ne kemi bërë propozimin tonë kemi pasur parasysh kushtet jashtëzakonisht të këqija për dyqanet që mbajnë kafshë për shitje në Tiranë dhe në të gjithë Shqipërinë. Mund të ketë nevojë për t'u rregulluar. Pra, nuk e kemi pasur për qytetarët, sepse mund të ketë njerëz shumë të varfër dhe kanë një nivel higjienë të caktuar, por bëhet fjalë për dyqanet, që janë veprimtari fitimprurëse dhe keqtrajtojnë kafshët për mënyrën si i mbajnë dhe kanë lloj-lloj sëmundjesh. Po të futemi në këtë diskutim, do të habiteni sa viruse kalojnë në këto dyqane. Në propozimet e 37 mijë e 500 qytetarëve me të drejtë vote trajtohet keqtrajtimi i kafshëve, vrasja e kafshëve të rralla të simbolit kombëtar, si shqiponja, braktisja, ndeshjet me kafshët. Braktisja mund t'ju duket shumë e pavend, por sjell shpenzime për qytetarët, për pushtetin vendor, për shtetin, për taksat tona, pasi një kafshë e braktisur në rrugë, në një vend normal, duhet të trajtohet. Pra, një institucion i caktuar duhet ta marrë kafshën nga rruga, ta ushqejë, ta çojë në vende të caktuara për grumbullimin e kafshëve dhe kjo ka një pasojë financiare për të gjithë shoqërinë.

Kemi pa fund video se çfarë ndodh në Republikën e Shqipërisë, ku kafshët tërhiqen zvarrë me makinë, varen në litarë, u pritët koka, u priten gjymtyrët, hidhen në lumë, ka helmime masive. Helmimi është një fenomen shumë masiv dhe shqetësues, të cilin edhe ju duhet ta trajtoni. Helmet shiten pa asnjë kontroll në të gjitha pikat, në çdo treg në Shqipëri, dhe secili mund të blejë helm dhe të helmojë kafshë dhe qytetarë.

Bastet po ashtu janë një fenomen shumë shqetësues. Në shumë qytete të Shqipërisë bëhen organizime ndeshjesh me kafshë, ku një prej kafshëve ngordh pas ndeshjes. Bëhen kampionate në Durrës, në Pogradec, në Vlorë, në Tiranë te parku "Rinia". Ky fenomen është shumë shqetësues.

Edhe një herë, se ndoshta e ekzagjerova, por ju jap kurajë që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, por njerëzit ndeshen me vetëdije dhe për një qëllim të caktuar.

Robert Bitri – Ku e di ti që nuk e kanë vetëdijen?

Indrit Osmani - Për t'u ndeshur?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duhet të marrsh një kafshë në shtëpi, që ta kuptoni se nuk kanë vetëdije për t'u ndeshur.

Robert Bitri - E kam, ndaj po ju them.

Indrit Osmani - Kafsha juaj do të ndeshet?

Robert Bitri - Mbase do të ndeshet.

Indrit Osmani - Mbase është edukuar keq.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord.

Kjo është nisma jonë, është nismë e 37 mijë e 500 qytetarëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju keni të drejtë ta rrëzoni, të talleni, të qeshni. Bëni si të doni.

Niko Peleshi – Mos e ktheni në debat!

Robert Bitri – Pse e merr për tallje? Ne po flasim tamam.

Indrit Osmani – Kjo ishte përgjigjja ime.

Robert Bitri – Kjo është pyetja ime dhe ti e ke për detyrë t'i përgjigjesh.

Niko Peleshi – Mbaruat, zoti Bitri?

Zoti Bare ka kërkuar fjalën.

Besnik Baraj – Atëherë, unë bashkohem me të gjitha komentet që bëtë ju dhe tërhiqem nga sugjerimi që bëra për kushtet higjienosanitare, meqenëse ju i keni parasysh për qendrat ku shiten dhe domosdoshmërisht atje duhet të ketë kushte vërtet me standarde, sepse janë qytetarët që shkojnë të blejnë dhe mund të marrin infeksione, por kjo duhet përcaktuar në ligj, që domethënë bëhet fjalë për qendrat ku ruhen ose për qendrat spitalore të kafshëve, ku duhet respektuar higjiena. Nuk e di nëse e keni përfshirë në mënyrë specifike, por duhet bërë, sepse merren infeksione.

Unë bashkohem me mendimin tuaj, që kafshët nuk duhen lejuar të ndeshen me njëra-tjetrën.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Baraj!

Zoti Bici.

Dritan Bici – Mbrojtja e kafshëve më duket një nismë e mirë, sepse çdo qenie e gjallë që ka ardhur në këtë botë ka të drejtën e vet të jetojë, të cilën ia jep Zoti dhe nuk mund ta tjetërsojë njeri.

Marr shkas nga problemi i madh i krijuar në vendin tonë. Gjithandej, në çdo qytet që shkojmë, edhe në plazhe, është një numër i madh i shtuar i qenve rrugaçë, të cilët janë bërë problem për njerëzit dhe mjedisin. Duhet t'i kushtojmë vëmendje kësaj situatë, duhet zgjidhur, sepse është shumë problematike. Çdo njeri, që zgjohet herët në mëngjes për të shkuar në punë në këmbë ose me biçikletë, e ka problem për të kaluar nga qentë. Edhe vet jemi ndeshur me raste të tilla. Të mos flasim për fëmijët, që prindërit detyrohen t'i shoqërojnë, sepse qentë rrugaçë janë problem, aq më tepër që shumë prej tyre mbartin sëmundje të rrezikshme, sepse gërmojnë në kazanët e plehrave dhe mund të përhapin shumë sëmundje.

Ideja ime është që ne të miratojmë ligjin për të mbrojtur kafshët, por kjo duhet shoqëruar me buxhet, sepse ligjet bëhen kollaj dhe ne kemi bërë shumë ligje të mira, por si çdo sektor, dhe ky do të haset me mungesë buxheti, sepse ne si shtet nuk jemi aq të fuqishëm sa të mund të krijojmë buxhet për të gjitha kafshët rrugaçe, kafshët e braktisura, që të mbahen siç duhet, sepse kemi parë dhe e dimë si mbahen në vende të zhvilluara. Ne sot po diskutojmë ende ndihmën ekonomike, që sa vjen e shkurtohet, apo probleme të tjera sociale që ndeshen njerëzit. Ligj kishte edhe Ahmet Zogu, nëse e keni parë, më 1936-ën, që polici kap dikë dhe i thotë “mos e rrih kalin, sepse dënohesh”. Unë nuk jam i mendimit që këto punë të vazhdojnë siç janë, por njëkohësisht duhet t'i marrim seriozisht për ta shoqëruar me efektet financiare që ka.

Sot, për shembull, bashki si Tirana, Durrësi, Elbasani i gjuajnë qentë me gjilpëra paralizuese, i vënë në gjumë dhe më pas i lëshojnë në Gramsh, në Memaliaj, Tepelenë, në plazhin e Durrësit. Këto qytete janë mbushur, sepse Erion Veliaj ka disa lekë, i gjuan me shigjetë, i fut në fugon dhe i çon në Gramsh, në Korçë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kështu ka ndodhur, sepse kam qenë vet kryetar bashkie. Na vinin lukuni qensh dhe ne thoshim “çfarë bëhet kështu”. Kështu bëhet, ndaj këto punë duhen disiplinuar. Janë bërë vërtet problem, sepse nuk është estetike që në mes të ditës, para bashkisë, flenë 30 qenë te sheshi i

rilindjes urbane, i cili është ndërtuar për bukuri. Aty flenë qent, a kupton? Kjo ndodh gjithandej kudo që shkon. Edhe plazhi i Durrësit është mbushur plot me qen. Tani, ose duhet të vendoset një buxhet, në mënyrë që këta qen të trajtohen, siç i trajton e gjithë bota, ose duhen vrarë, sepse para jetës së njerëzve nuk do të vihet jeta e qenve.

Shteti duhet të marrë masa, në mënyrë që çdo qenie e gjallë të trajtohet me buxhete përkatëse, siç e bën e gjithë bota që i marrin dhe i mbajnë këto kafshë në pikat e grumbullimit, duke i trajtuar e kështu me radhë. Unë kam qenë kryetar bashkie dhe e kam ndjerë këtë problem, madje e dija që, nëse do t'i vrisja këto kafshë, shoqata e kafshëve do të më dilte kundër. Madje, ka pasur disa kryetarë bashkie, që nuk kanë rikandiduar, sepse shoqatat e kafshëve i kishin bërë palaço nëpër televizione sikur këta të ishin kriminelë, të cilët donin të vrisnin qentë.

Kështu që unë jam për ta miratuar këtë nismë, por do të kërkoja vëmendje nga qeveria për këtë çështje që të akordojë një buxhet të caktuar dhe të marrë masa, sidomos në lidhje me qentë e rrugës.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zonja Gjermani. Më pas fjalën e ka zoti Gjuzi.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua t'ju falënderoj si përfaqësues i mbi 35 mijë qytetarëve për nismën, për ndjeshmërinë, por edhe për modelin që po krijoni. Në fakt, nismat të tilla ligjore, që vijnë nga grupime të mëdha qytetarësh janë të pakta. Unë e vlerësoj ndjeshmërinë tuaj për këtë problem dhe uroj që kjo ndjeshmëri të jetë edhe për problematikat e tjera nga qytetarët, në mënyrë që ata të kenë një rol më proaktiv, siç duhet të jetë në një sistem demokratik.

Unë e kuptoj edhe ndjeshmërinë e të gjithëve në një situatë, ku ka probleme sociale, ekonomike, si dhe shqetësime të tjera, që qytetarët i konsiderojnë prioritare, por ne si ligjvënës kemi përgjegjësinë të shikojmë rëndësinë e të gjitha nismave që vijnë këtu dhe t'i diskutojmë ato për impaktin që do të kenë. Ne do të hartojmë dhe do të miratojmë ligje, të cilat do të edukojnë dhe do t'i paraprijnë rritjes së ndërgjegjësimit, por edhe do të krijojnë një model që të zbatohet, sepse ligjet nuk hartohen dhe miratohen vetëm sot për nesër, ndërkohë që edhe edukojnë.

Për shkak të ndërgjegjësimit relativisht të ulët, pavarësisht se ju keni marrë një mbështetje të konsiderueshme, flas për të gjithë shoqërinë shqiptare dhe për të gjitha grupimet, shqetësimi im është se në përgjithësi, jo vetëm ne si vend, por edhe vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat kanë ligje të mira, kanë vështirësi në zbatimin e tyre për shkak të nivelit të

ulët të ndërgjegjësimit, por edhe për shkak të mungesës së mekanizmave, që garantojnë zbatimin e tyre.

Unë dua t'ju pyes: në momentin kur ju e keni hartuar këtë nismë, a keni menduar se si do të jetë mënyra apo mekanizmi, që kjo gjë të funksionojë? Si do të monitorohet dhe si do ta garantojë zbatimin kjo nismë ligjore? Flasim për kontekstin shqiptar.

Faleminderit!

Kujtim Gjuzi - Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj përfaqësuesit e shoqërisë civile në mbrojtje të kafshëve, që kanë ardhur këtu. Kjo është një nismë shumë e mirë, por nuk jam dakord me disa kolegë, të cilët thonë se ne nuk kemi kujdestari për kafshët. Qeni i Sharrit është shumë i hershëm dhe ne jemi kujdesur gjithmonë për këtë kafshë, pra ne kemi kampionin e kampionëve, në kuptimin e mbrojtjes së një shoqëruesi të qytetarëve shqiptarë. Para se unë të jap votën time pro në lidhje me këtë nismë që keni propozuar, do të kërkoja nga ju mirëkuptimin, sepse ndoshta jam i painformuar, të më thoni: a nuk ka mundësi që në një propozim të veçantë ju të ...

(Mungesë incizimi.)

Pra, ne të gjithë së bashku kemi hasur edhe në orët e mëngjesit, por edhe në orët e vona të natës të na afrohen jo vetëm qentë e rrugës, por edhe qentë me pronarë. Ju i keni parë dhe besoj se të gjithë jeni trembur. Pra, si do të zgjidhet kjo situatë?

Unë jam dakord me nismën që ju propozoni, sepse jeni 37 mijë e 500 qytetarë shqiptarë, që keni vënë firmën dhe këtë të drejtë unë nuk do ta refuzoja në asnjë mënyrë, por te projekti, që keni sjellë, pse nuk e keni parashikuar edhe këtë pikë? Nuk është pyetje provokuese, por është pyetje dashamirëse. A do të mundemi ne që të shtojmë një pikë këtu dhe t'u themi këtyre pronarëve të kafshëve që, kur të dalin me qenin e tyre në rrugë, ta mbajnë të veshur? Për shembull, ashtu siç i veshin bluza qenve, ashtu t'i vendosin edhe atë maskën mbrojtëse, që të mos na kafshojnë në rrugë.

Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe ju që më dëgjuat!

Niko Peleshi – Po, zoti Jakimi dhe më pas zoti Musaj.

Ju lutem, mbajini shënim të gjitha pyetjet, në mënyrë që të na jepni një përgjigje të përmbledhur.

Halil Jakimi – Personalisht, e përshëndes nismën e qytetarëve dhe veçanërisht aktivistët e shoqërisë civile, të cilët kanë bërë të mundur të sjellin në komision këtë nismë ligjore. Unë do të ndalesha pak te pjesa që përmendi edhe kolegu Bici më parë, ku çdo bashki duhet të ketë qendra sterilizuese, pasi ka qen agresivë dhe duhen neutralizuar dhe duhen rregulluar. Ky është një problem i madh dhe një hendek ndërmjet trajtimit shëndetësor të kafshëve dhe agresivitetit që ata kanë, duke u bërë rrezik serioz për qytetarët, pasi dihet që shumë qenë transportohen edhe në zona të ndryshme. Kjo është shumë e vërtetë dhe ka shumë qen të braktisur, duke i përdorur kështu si mënyrë ripopullimi. Pra, një qen transportohet nga një qytet në një tjetër dhe ka qytete që mbipopullohen nga këta.

Një pikë që vlen për t'u përshëndetur, të cilën e mbroj shumë është masa penale që merret për ata që vënë baste në ndeshjet midis kafshëve. Me mbylljen e basteve, kjo është kthyer në një traditë, sepse në ndeshjet midis qenve vihen baste në shuma të konsiderueshme. Normalisht, unë për këtë them të dënohen edhe më shumë nga ç'është vlera në këtë projektligj, të dënohen jo vetëm organizuesit, por edhe njerëzit që vendosin baste për këto ndeshje, pasi është një keqtrajtim shumë i madh që u bëhet qenve të rrugës.

Së fundi, ka njerëz që i blejnë dhe i përgatisin këta qen direkt për ndeshje dhe për qëllime përfitimi financiar.

Pyetja ime është: ku jeni bazuar në formulimin e këtij ligji? Modelin e cilit shtet keni ndjekur, gjithmonë nëse keni adoptuar një model të tillë?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Musaj.

Më pas fjalën e ka zoti Konomi dhe më pas zoti Baraj.

Nimet Musaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Ky është një ligj interesant në pamje të parë dhe e vlerësoj, por dua t'u bëj një pyetje zotërinjve të nderuar që janë këtu.

Në pikën 1 të nenit 5 thuhet: "Përdorimi i lëkurës së kafshëve të shoqërimit, për prodhimin dhe konfeksionimin e artikujve të lëkurës, peliçeve, veshmbathjeve apo prodhime të tjera prej lëkure, që e kanë origjinën tërësisht apo pjesërisht nga lëkura apo peliçja e kafshëve të mësipërme, dënohet me burgim nga një deri në dy vjet dhe me gjobë deri në 500 000 lekë."

Personalisht, mendoj se alternativat janë të rënda, sepse vihen njëkohësisht edhe dënimi me burg, edhe një gjobë 5 milionë lekë. Kjo sikur nuk shkon, apo jo?

Së dyti, ne duhet të kemi alternativa të tjera lehtësuese, sepse prandaj jemi ligjbërës dhe herë pas here problematikat, që do të dalin me kalimin e kohës, na japin të drejtën që t'i rishikojmë, por pa një sensibilizim të të gjitha formave, mendoj se do të jetë shumë e vështirë për qytetarët dhe përdoruesit e këtyre kafshëve.

U shprehët ju, zotërinj të nderuar, që nga gazetatat zyrtare u njohët edhe me vendimin që kanë marrë kolegët tanë në Kosovë. Duhet ta kishit parë dhe t'ua përshtatnit kushteve të infrastrukturës sonë.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Zoti Konomi e ka fjalën. Pas zotit Konomi do të flasë zoti Baraj, se e ka kërkuar më parë fjalën. Më pas e kanë fjalën zoti Shtjefni dhe zoti Pëllumbi.

Ardit Konomi –Faleminderit!

Pa diskutim, nisma është për t'u përshëndetur, madje mendoj se është disi e vonuar. Bashkohem me qëndrimin tuaj, kryetar, që ky është një tregues i fortë emancipimi.

Megjithatë, po i referohem një ligji të ngjashëm, me të cilin jam njohur vite më parë dhe besoj se është modeli i duhur për t'iu referuar.

Në tërësi, propozimi i këtij projektligji është i mirë, por është disi ambigue dhe nuk i prek të gjitha detajet, që duhet të prekë një ligj i tillë për t'u bërë sa më i zbatueshëm.

Te ligji në fjalë ka një ndarje të llojit të keqtrajtimit. Ka një ndarje midis llojit të kafshëve, që janë subjekte keqtrajtimi: kafshë pune, kafshë barre, kafshë shoqërimi e me radhë.

Ka pasur një paketë të përcaktimit të përgjegjësive, të cilat fillojnë që nga caktimi i përgjegjësive për njësitë e qeverisjes vendore, për kafshët në territorin e tyre, për të cilat janë përgjegjëse, për kafshët e braktisura, mënyra se si do të strehohen, përkujdesja për to e me radhë, deri te mënyra se si shoqërohen në ambientet publike.

Di që, në një moment të caktuar, për ta thjeshtuar këtë ligj, një pjesë e kësaj pakete është e detyruar të bëhet në paketën e rregulloreve funksionale të bashkive. Ndoshta një këndvështrim i tillë mund të ndihmonte në rregullimin e gjithë marrëdhënies së vendosur brendapërbrenda.

Niko Peleshi –Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Faleminderit!

A mendoni se duhet të përfshihet një detaj apo një nen, që, kur qeni ndot, vetë pronari të ketë përgjegjësi? Sepse rëndom shohim nëpër rrugë ndotje të qenve, që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Jo vetëm të qenve.

Besnik Baraj – Është gjobë për pronarin.

(Diskutime pa mikrofon)

Masat parandaluese janë më të mira se...

Niko Peleshi – Zoti Shtjefni, zoti Pëllumbi dhe zoti Marto.

Zef Shtjefni – Faleminderit, zoti kryetar!

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Zoti Shtjefni, të lutem, se...!

Zef Shtjefni – Në fakt, është e rëndësishme, por duke mos qenë specialistë të kësaj pune... Ata që kanë punuar në bashki kanë të drejtë dhe e njohin më mirë situatën. Këtë duhet ta themi.

Mua më shqetëson vetëm ana ligjore. E pashë ndëshkimin me gjobë, që kanë vënë këta, qoftë edhe me burgim. Jam i mendimit (nuk po e vendos) që masat për gjoba janë të drejta, ndërsa burgim deri në 3 vjet... Çfarëdolloj mase të jetë, e fundit duhet të jetë 1 vit burg, pra sipas rastit, por jo të shkojë deri në 3 vjet.

Kaq kisha.

Faleminderit!

Niko Peleshi - Zoti Pëllumbi, zoti Marto...

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar!

Edhe unë i bashkohem gjithçkaje u tha për iniciativën tuaj. Ju falënderojmë!

Dëshiroj të ritheksoj atë që tha edhe kryetari i komisionit, që, pavarësisht se ju e keni depozituar që në vitin 2017 këtë nismë, ndryshimi i Kodit Penal nuk mund të bëhet në çdo lloj momenti. Ky është momenti kur ne po rishqyrtojmë dhe shqyrtojmë disa ndryshime në Kodin Penal dhe mendojmë, siç kemi folur edhe me kolegë të tjerë të Komsionit të Ligjeve, që nismën tuaj ta bashkëngjisim në të gjithë procesin e ndryshimeve që po i bëjmë Kodit Penal.

Sigurisht (marr shkas edhe nga ajo që thanë kolegët), ju keni parashikuar në nismën tuaj, aspektin e mbrojtjes së kafshëve, por ne, si ligjvënës, jemi duke parashikuar edhe mbrojtjen

e njerëzve kur sulmohen nga kafshët. Pra, po bëjmë një paketë të plotë të të gjithë aspektit se si njerëzit u afrohen kafshëve dhe kafshët u afrohen njerëzve.

Gjithashtu, marr shkas edhe nga ajo që tha kolegu Baraj, në ndryshimet e paraqitura të Kodit Penal, të cilat ne i diskutuam dje, është marrë parasysh edhe shkëlja e rregullave të mbajtjes së kafshës së shoqërimit.

Jonel Kristo – Më fal, zoti Pëllumbi!

Nuk po e dëgjoj zotin Pëllumbi. A mund ta dëgjojmë pak?

Arben Pëllumbi – Në këtë aspekt, një pjesë të mirë të shqetësimeve që ngritëm këtu, mendoj se i gjejmë të materializuara, si në pjesën ku kolegët tanë kanë propozuar si nismë ndryshimin e Kodit Penal, ashtu edhe në nismën që keni depozituar ju për pjesën tjetër të ndryshimeve të Kodit Penal.

Nuk i heq asgjë shqetësimit të kolegëve të mi për situatën ku ndodhemi, për më tepër, për kulturën që kemi në raport me kafshët. E kam fjalën këtu, si për kafshët e shoqërimit, pra për kafshët shtëpiake, ashtu edhe për kafshët që gjuhen në mënyrë të padrejtë apo janë drejt zhdukjes.

Dua ta theksoj (nisma juaj nuk kufizohet vetëm me kafshët shtëpiake), se gama e ndryshimeve të Kodit Penal ka të bëjë me një spektër shumë më të gjerë të mënyrës se si njerëzit u afrohen qenieve të pambrojtura, që kanë të drejtën e tyre për të jetuar.

Sigurisht, jam dakord që një sjellje e caktuar e dhunshme ndaj një kafshe, sidomos në moshë të re, ka indicie që, në të ardhmen, kur të jesh më i rritur, të të çojë edhe në dhunë ndaj njerëzve. Për këtë ka plot shembuj.

Gjithsesi, duhet të kemi parasysh që nga shqyrtimet, që do të bëhen nga ekspertët e Komisionit të Ligjeve në bashkëpunim me EURALIUS-in dhe ekspertët e prokurorisë, do të shikohet edhe masa e dënimeve, duke marrë parasysh edhe propozimet që kanë kolegët e tjerë për këtë.

Në parim, besoj se të gjithë kolegët janë dakord me nismën që ju keni ndërmarrë, por kjo është një nismë që do të kalojë filtrat e saj legjislativë në parlament, për të marrë parasysh ato që propozoni ju dhe atë që propozojnë kolegët tanë, për të dyja aspektet, të mbrojtjes së kafshëve dhe të mbrojtjes së njerëzve nga kafshët.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Zoti Marto, do t'ju lutesha të keni parasysh që në orën 12:00 duhet ta keni mbaruar seancën! Kështu që, duhet t'i bëni shkurt pyetjet, po ashtu, edhe përgjigjet duhet t'i jepni shkurt.

Andrea Marto –Faleminderit, zoti kryetar!

Kisha një pyetje: a duhet t'i parashikojmë në ligjin aktual kushtet që duhet të plotësojnë subjektet për të zotëruar kafshë shtëpiake? Për ta thjeshtëzuar: në një pallat apo një subjekt me një dhomë e një kuzhinë, a mund të mbahet një qen, i cili ka një madhësi që tremb gjithë pallatin?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit për pyetjet!

Jonel dhe Indrit, do t'ju lutesha të jeni sa më sintetik në përgjigje, sepse në orën 12:00 kemi një aktivitet tjetër.

(Diskutime pa mikrofon)

Të dëgjojmë përgjigjet dhe komentet e Jonelit dhe Indritit.

Jonel Kristo – Do të përpiqem t'i bie shumë shkurt. Pyetjet ishin shumë interesante.

Do ta nis me zonjën Gjermani.

Qëllimi kryesor i nismës sonë është i dyfishtë, pra ne duam ta parandalojmë së përsërituri këtë problem në të ardhmen dhe duam të ofrojmë një zgjidhje për këtë që kemi sot, siç e tha edhe zoti Bici më parë.

Kemi dy struktura në shtet, që e kanë detyrë menaxhimin e këtij fenomeni: shërbimi veterinar dhe Policia Bashkiake, së bashku me agjencinë për mbrojtjen e konsumatorit.

Shërbimi veterinar e ka të detyruar me ligj të merret me rastet kur ka kafshë të rrezikshme në rrugë (për shembull, kur janë të sëmurë, kur kafshojnë, janë agresivë e kështu me radhë), ndërsa Policia Bashkiake ka për detyrë t'i sinjalizojë këto kafshë, por edhe njerëzit që keqtrajtojnë kafshët. Për shembull, një polic bashkiak në Laç po bënte incizimin e një ndeshjeje me kafshë. Nuk është ky roli i Policisë Bashkiake, por atë foton duhet ta denonconte për ta bërë...

Dua të prek pak çështjen e buxhetit, sepse është shumë i rëndësishëm. Vetëm Tirana ka rreth 6000 qen. Po të sterilizohen gjithë qentë në Tiranë (në privat kushton 40 euro për një qen), në total, brenda vitit, Tiranës i duhen 270 mijë euro për të zgjidhur problemin e qenve. Korça ka rreth 3000 qen dhe i duhen më pak se 100 mijë euro për të zgjidhur problemin e qenve. Pra, Tiranës i duhen 270 mijë euro, ndërsa Korçës më pak se 100 mijë euro.

Ju po kërkon një zgjidhje të shpejtë. Zgjidhja që ne ofrojmë është e mirë, por të dyja bashkë nuk bëhen dot. Nuk ekziston një zgjidhje e mirë dhe e shpejtë.

Kemi që në '93-shin që vrasim qen. Sikur një qen në ditë të vrisnim, do t'i kishim vrarë gjithë qentë në Shqipëri dhe nuk do të kishim më probleme. Problemi është që nuk funksionon ashtu, që e hoqe një qen dhe do të vijë tjetri nga rrethina, do të zërë atë dhe do të shtohet...

Prandaj, sterilizimi është zgjidhja afatgjatë. Fatkeqësisht, është zgjidhje e avashtë, por është humane dhe nuk i rrezikon njerëzit. Kjo bëhet paralelisht me shërbimin veterinar, që merr masat e veta për qentë që kafshojnë, janë agresivë, të sëmurë, por qentë normalë sterilizohen dhe ngordhin natyrshëm.

Kështu e ka zgjidhur problemin India, që ka me miliarda qen endacakë. Edhe Gjermania dhe Katovica e kanë pasur shumë të madh këtë problem, por e kanë parandaluar me gjoba braktisjen e qenit dhe e kanë zgjidhur nëpërmjet sterilizimit.

Kështu që, nga ana buxhetore, po flasim për gjëra qesharake, pra me rreth më pak se 300 mijë euro Tirana e zgjidh këtë problem.

Dua të them edhe një gjë: në një kohë kur privati e sterilizon qenin me 40 euro, shteti e sterilizon me 6 euro, në qoftë se strukturat do të funksiononin. Buxheti nuk është as çështje dytësore.

Indrit, të lutem, për pjesën ligjore...!

Indrit Osmani – Në fakt, unë i përmbledha. Disa deputetë të nderuar bënë pyetje shumë të ngjashme.

Për sa i përket pyetjes për rregullat e qarkullimit të kafshëve shtëpiake, sipas ligjit në fuqi për shërbimin veterinar, prej shumë vitesh, nxjerrja e akteve nënligjore i ngarkohet pushtetit vendor.

Me sa di unë, këshilli bashkiak i Tiranës i ka miratuar aktet nënligjore dhe ka vendosur gjoba për pronarët, që nuk i mbledhin jashtëqitjet e kafshëve, si dhe ka vendosur rregulla për mbajtjen e maskave për qen të caktuar dhe rregulla të tjera. Pra, kjo është një gjë tashmë e zgjidhur, mjafton të zbatohet ligji. Secila bashki duhet të marrë masat e veta, për të cilat ligji ia ka dhënë të drejtën.

Për sa i përket modelit të ligjit, në fakt, ne kemi marrë modelin e kodit penal italian, i cili është miratuar në fillim të viteve '90. Ka pasur dy modele në Europë: modeli i parashikimit vetëm në Kodin Penal, si vepra penale, të cilat kanë kosto shumë më të ulëta për mbikëqyrjen

dhe zbatimin e këtyre neneve (sepse prokuroria zhvillon një hetim dhe policia zhvillon hetimin dhe ndëshkon me masë penale) dhe modeli ku të dyja legjislacionet parashikohen në Kodin Penal, por edhe në ligje të posaçme. Për Shqipërinë ndoshta kjo mund të jetë pak e hershme, sepse nëse do të parashikoheshin me ligj të posaçëm, do të krijoheshin një institucion tjetër, që do të mbikëqyrte plotësisht këtë ligj në Republikën e Shqipërisë, të kishte degë në çdo qytet e të tjerë.

Si fillim, menduam se mjafton ndëshkimi i veprave kryesore, sepse nuk janë vetëm veprat penale ndaj mirëqenies së kafshëve dhe mjedisit, por ka edhe shumë të tjera, disa prej të cilave mund t'i lexoni te legjislacioni i Kosovës dhe janë shumë më të detajuara.

Për sa u përket peliçeve të kafshëve, bëhet fjalë për kafshët e shoqërimit, jo për çdo lloj lëkure kafshe. Përdorimi i peliçeve të kafshëve të shoqërimit (sipas legjislacionit “Për shërbimet veterinare në Republikën e Shqipërisë”, kafshë shoqërimi konsiderohen macja dhe qeni) konsiderohet një shkelje shumë e rëndë, sepse ndërton një industri të paligjshme të shtimit të kafshëve vetëm për t'i rritur dhe rrjepur, për t'i vrarë... Të mos futemi pastaj te mënyra e vrasjes, sepse, për t'ia marrë peliçen kafshës, kjo e fundit duhet të jetë thuajse e gjallë. Kjo është teknika që peliçja të jetë sa më e mirë.

Pra, bëhet fjalë për kafshët e shoqërimit, jo për çdo lloj kafshe tjetër që ekziston apo për peliçet e llojeve të tjera, që, në vlerësimin tonë, as ato nuk duhet të ekzistojnë, por ne nuk kemi shkuar më tej. Kemi dashur të parandalojmë një industri të shtimit të kafshëve të shoqërimit në ambiente të caktuara për t'i rrjepur dhe për t'i vrarë.

Për sa u përket masave, e shpjegova, është pushteti vendor ai që ka tashmë me ligj të drejtën për të vendosur masa për rregullat e shoqërimit të kafshëve, maskat e të tjerë.

Për sa u përket kushteve që duhet të plotësojnë qytetarët për të mbajtur kafshët, kjo varet nga secili qytetar...

Për shembull, në Itali mund t'ju përmend se me ligj është e lejueshme mbajtja e 5 qenve për apartament, pra nuk lejohet mbajtja mbi 5 qenve. Edhe kjo për shkak të mirëqenies së kafshës, sepse ligjvënësi ka menduar që një person, i cili mban mbi 5 qen në një apartament, nuk do të mund t'i shërbejë kafshës ashtu siç duhet, sipas nevojave të tij ekologjike.

Këto kishim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Dakord.

Shumë faleminderit, Jonel! Shumë faleminderit, Indrit!

Me sa u duk qartë, të gjithë anëtarët e komisionit e mbështesin nismën, e vlerësojnë dhe duket që ka një dakordësi në parim, por, gjithsesi, kjo do të votohet tani.

Unë propozoj që ne si komision, në fakt, edhe siç na takon, ta votojmë në parim. Besoj se do ta miratojmë, sado që personalisht e them që tani se do ta votoj pa asnjë hezitim si nismë, për t'ia përcjellë më pas Komisionit të Ligjeve për ta integruar brenda nismës së një grupi deputetësh për ndryshimet e tjera në Kodin Penal, sepse, siç e thanë zoti Shtjefni, që është edhe i fushës, por edhe të tjerët, ne e kemi të vështirë t'i vendosim në shkallë proporcionale masat ndëshkimore, në raport me masat e tjera. Komisioni, që mund ta harmonizojë këtë aspekt, është Komisioni i Ligjeve, ndaj në qoftë se ne jemi dakord në parim, le ta votojmë dhe ta miratojmë dhe t'ia kalojmë Komisionit të Ligjeve për ta integruar me nismën tjetër, të cilën ne do ta shqyrtojmë në parim dhe nen për nen, menjëherë pas kësaj seance.

Kush është dakord të procedojmë kështu?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Atëherë, hedhim në votim në parim nismën e një grupi zgjedhësish (qytetarësh) për ndryshime në Kodin Penal, që kanë lidhje me mirëqenien e kafshëve. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Dy vota abstenim.

Me dy abstenime dhe të gjitha votat e tjera pro, miratohet në parim kjo nismë.

Ju falënderoj dhe ju inkurajoj për nisma të tjera, siç e tha edhe zonja Gjermani, kaq qytetare!

Faleminderit!

Jonel Kristo – Ju falënderojmë shumë, pasi keni qenë komisioni më dashamirës dhe më mikpritës!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Niko Peleshi – Edhe diçka të vogël për kolegët deputetë, ne kemi planifikuar diskutimin në parim, ndoshta edhe nen për nen të ndryshimeve të Kodit Penal, por, meqenëse kemi mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve, mua dhe zotit Musaj na duhet të shkëputemi, besoj, për 15 minuta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ose e bëjmë pushim, ose shqyrtimin nen për nen të projektligjit e lëmë për të hënë. Si e mendoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një minutë, Kujtim, t'i dëgjojmë edhe të tjerët!

Si mendoni? Bëjmë një pushim prej 15 minutash?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si mendoni, zoti Beqaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të hënën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, e lëmë të mblihdemi të hënën, meqenëse shumica e anëtarëve është dakord.

Faleminderit të gjithëve!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA